



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITETI
"HAXHI ZEKA"

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERZITETI "HAXHI ZEKA" PEJE	
REKTORATI			
Nr. / Br. / No. <u>2027</u>		Nr. i faq/ Br. str / No. pg <u>18</u>	
Data / Datum / Datë: <u>27.10.2020</u>			Pejë / Peć

Këshilli Drejtues

Ref.

Datë:

KODI I ETIKËS PËR STAF AKADEMIK DHE STUDENTË I UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA" NË PEJË

Pejë, Tetor 2020

**KODI I ETIKËS PËR STAFIN AKADEMIK DHE STUDENTË I UNIVERSITETIT
"HAXHI ZEKA" NË PEJË**

PARIMET E PERGJITHSHME

1. Duke u bazuar në lirinë akademike të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës për veprimtari studimore, hulumtuese dhe artistike, dhe në autonominë që gëzon universiteti, Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë miraton Kodin për Stafin Akademik dhe Studentë.
2. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë nëpërmjet këtij dokument përcakton dhe garanton detyrat dhe përgjegjësitë etike dhe sjelljen e përgjegjshme të personelit akademik, personelit menaxherial dhe studentëve për ndjekjen e qëllimeve akademike dhe kërkimore, për nxitjen e meritës dhe përsosmërisë, për krijimin e një mjedisi profesional që është i bazuar mbi standarde të rrepta shkencore dhe profesionale, respekt për të drejtat e të tjerëve, sjellje etike dhe ndërgjegjësimi për ndikimin që shkenca ka mbi njeriun dhe mjedisin që e rrethon, marrëdhënieve ndërpersonale dhe mbrojtjes së vlerave individuale.
3. Ky dokument i kërkon personelit akademik, personelit menaxherial dhe studentëve, të përmbushë dhe të promovojë parimet themelore dhe vlerat e etikës siç janë: Integriteti; Ndershmëria; Vërtetësia; Transparenca; Respekt për të tjerët; Llogaridhënia; Drejtësi; Barazi, Drejtësi Sociale; Mirëbesimi; Objektiviteti; Sinqeriteti; Liria Akademike

Neni 1

Qëllimi

1. Ky Kod ka për qëllim ndërtimin e një mjedisi funksional akademik të punës, nxitjen e sjelljes së vërtetshme si dhe parandalimin dhe trajtimin e rasteve të sjelljeve joetike ose të paligjshme brenda universitetit.
2. Synon të ruajë vlerat themelore të komunitetit akademik, të ndërgjegjësojë personelin akademik, personelin menaxherial dhe studentët dhe të ndërtojë kulturë institucionale dhe akademike të bazuar në standardet etike, ligjore, të sigurojë ambient bashkëpunues akademik, ndërmjet personelit akademik dhe administrativ, me studentët, dhe me secilin person ose grup tjetër që kanë marrëdhënie kontraktuale ose interes që ka të bëjë me punën e universitetit.
3. Siguron njohjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive individuale akademike si dhe siguron respektimin e detyrave dhe përgjegjësisë etike të personelit akademik, personelit menaxherial dhe studentëve ndaj institucionit. Përcakton rregullat e sjelljes së komunitetit akademik dhe akterëve të lartcekur që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë gëzojnë marrëdhënie me Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.

Neni 2

Fusha e veprimit

1. Kodi i Etikës është i detyrueshëm për të gjithë personelit akademik, personelit menaxherial dhe studentëve, pavarësisht nga forma dhe lloji i kontratës së punës, personel akademik, bashkëpunëtorë të rregullt dhe të angazhuar, hulumtuesit, laborantët, stafin menaxherial dhe studentët që janë pjesë e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.
2. Kodi i Etikës shtrin efektet e tij në gjithë veprimtarinë dhe funksionimin e Këshillit të Etikës.
3. Personeli administrativ ka Kod veçantë të Etikës andaj nuk përfshihet në këtë Kod.



KREU I
PËRGJEGJËSIA, PAVARËSIA KEQPËRDORIMI I DETYRËS DHE KONFLIKTI I INTERESAVE

Neni 3

Përgjegjësitë dhe konflikti i interesave

1. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë është institucion i lirë dhe i pavarur nga të gjitha format dhe kushtëzimet e interesave të jashtme. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë kërkon që anëtarët e tij, në kryerjen e detyrave të tyre institucionale, të respektojnë parimet e korrekhtësisë dhe paanësisë, duke punuar para së gjithash në interes të universitetit duke shmangur situatat e konfliktit të interesave. Çdo anëtar i personelit akademik, personelit menaxherial dhe studentëve të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, gjatë kryerjes së detyrës duhet të angazhohet që:
- a. Të promovojë interesat më të mira të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë;
 - b. Të nxisë misionin, vizionin dhe vlerat e universitetit;
 - c. Të ruajë respektin dhe besimin e publikut ndaj Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë dhe integritetit të tij;
 - d. Të shfaqë dhe reflektoj integritet personal, ndershmëri dhe përgjegjësi në të gjithë veprimet e tij;
 - e. Të sigurojë ambient të respektit reciprok, të paanshmërisë dhe bashkëpunimit;
 - f. Të ruajë fshehtësinë e të gjitha çështjeve që konsiderohen konfidenciale;
 - g. Të sigurojë pavarësinë e gjykimit të drejtë nga interesat kontradiktore;
 - h. Të sigurojë që marrëdhëniet që janë ose mund të perceptohen si konflikte interesi, të jenë plotësisht të hapura dhe të ndiqen nga udhëzimet e organeve drejtuese të universitetit;
 - i. Të ketë përputhshmëri me politikat dhe procedurat e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë dhe ligjet në fuqi;
 - j. Të demonstrojë përkujdesje ndaj pronës dhe burimeve të universitetit;
 - k. Të respektojë orarin e punës të vendosur në marrëveshje me punëdhënësin ose eprorin;
 - l. Të respektojë orarin mësimor të miratuar dhe ndryshimet e tij në çdo rast;
 - m. Të ruajë paraqitje serioze gjatë orarit të punës, që përfshinë veshje serioze e dinjitoze;
 - n. Të përdorë gjuhën zyrtare dhe një fjalor të zgjedhur, me intonacione të rregullta dhe brenda normave të etikës e të sjelljes qytetare;
 - o. Të zbatojë me korrektësi detyrën dhe urdhrat e eprorit në përputhje me aktet ligjore e nënligjore;
 - p. Të shmangë rastet kur ka konflikt interesash sipas legjislacionit në fuqi, duke i deklaruar ato përpara eprorit, sapo të jenë shfaqur;
 - q. Të mos lejojë që marrëdhëniet personale, bindjet politike apo fetare të prekin marrëdhëniet profesionale;
 - r. Të mos kërkojë dhe të mos pranojë në asnjë formë privilegje, përfitime, ndërhyrje, favorizime, pagesa apo dhurime, nga studentë apo persona të tjerë, që kanë për qëllim marrjen e rezultateve favorizuese, të pa merituarra prej tyre, apo favore e përfitime të tjera të cilat anëtari i personelit akademik, personelit menaxherial dhe studentëve mund t'i kryejë për shkak të detyrës;
 - s. Të mos bëjë dallime ndër studentë, vartës apo kolegë për shkak të njohjeve apo preferencave personale;



- t. Të mos bëjë dhe të mos bëhet pre e provokimeve, ngacmimeve të të gjitha formave nga studentët apo personave të tjerë për shkak të punës, për qëllime që bien në kundërshtim me këtë Kod, aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me normat morale;
- u. Me veprimet e tij të mos çënojë dinjitetin, personalitetin, figurën dhe mendimet profesionale të kolegëve dhe autoriteteve drejtuese të çdo niveli, pavarësisht mospërputhjeve dhe konfliktit të interesave;
- v. Të mos konsumojë pije alkoolike, duhan apo pije narkotike në ambientet e institucionit;
- w. Të mos përdorë hapësirat universitare për aktivitete që nuk lidhen me mësimdhënien;
- x. Të mos u bëjë presion studentëve në çfarëdo formë, me shkak apo pa shkak .
- y. Të mos përgojë, të mos shpifë e të mos njoftojë imazhin profesional e personal të anëtarëve të tjerë të personelit akademik, personelit menaxherial dhe studentëve të universitetit.

Neni 4

Përdorimi i burimeve të universitetit

1. Çdo anëtar i universitetit duhet të përdorë burimet e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë në mënyrë të përgjegjshme dhe të duhur, në mënyrë që të mund të justifikojë shpenzimet dhe të ofrojë dokumentacionin apo informacionin e nevojshëm, për çfarëdo shpenzimi apo kërkesë financiare.
2. Asnjë anëtar nuk i lejohet të përdorë apo t'u lejojë personave apo institucioneve/individëve të jashtëm pajisje të kërkimit, hapësira apo burime njerëzore, materiale ose financiare të universitetit, për qëllime të natyrës personale dhe/ose për qëllime të ndryshme nga ato të institucionit universitar, apo në çdo rast jo shprehimisht të aprovuara nga ky i fundit.

Neni 5

Përdorimi i emrit të universitetit

1. Të gjithë anëtarët e universitetit duhet të respektojnë emrin dhe imazhin e universitetit, me përjashtimin kur ka autorizim të shprehur. Asnjë anëtar i universitetit nuk i lejohet:
 - a. të përdorë në mënyrë jo të duhur logon dhe emrin e universitetit;
 - b. të përdorë emrin e universitetit në lidhje me veprimtari profesionale, punësime, detyra, apo veprimtari të tjera të jashtme, edhe jo të paguara;
 - c. të shprehë pikëpamje ngushtësisht personale duke përdorur emrin e universitetit.

Neni 6

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale

1. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë siguron dhe mbron të drejtat dhe liritë themelore, dinjitetin dhe privatësinë të të gjithë personave të punësuar në universitet, apo në ndonjë mënyrë tjetër kanë krijuar raporte me universitet. Universiteti kërkon që anëtarët e komunitetit akademik të përdorin të dhënat në lidhje me veprimtarinë e universitetit brenda roleve që ata kryejnë dhe në përputhje me sekretin profesional, duke siguruar konfidencialitetin e çdo informacioni të marrë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
2. Universiteti merr përsipër të sigurojë ruajtjen e privatësisë të çdo individi, duke përfshirë personelin akademik të rregullt dhe të angazhuar, stafin administrativ, studentë dhe persona tjerë që në ndonjë mënyrë kanë krijuar raporte me universitetin.



Neni 7

Keqpërdorimi i detyrës/pozicionit zyrtar

1. Personeli menaxherial, personeli akademik, bashkëpunëtorët, hulumtuesit, personeli administrativ dhe të gjithë ata që kanë lidhje direkte me universitet nuk u lejohej të përdorin, direkt apo indirekt, autoritetin e pozicionit të tij/saj akademik apo të zyrës së tij/saj tek të tjerët, duke ndërhurë në punën e tjetrit me qëllim që të detyrojë personelin tjetër të universitetit të kryejë shërbime në favor të tij apo të palës tretë, me përjashtim kur kjo është parashikuar si një detyrim juridik që rrjedh nga obligimi i përcaktuar me Statut dhe rregullore të tjera të universitetit.
2. Keqpërdorimi i pozitës i referohet sjelljes që synon marrjen e shërbimeve nga palë të tjera, ndërhurje në punën e tjetrit, cënimin e pavarësisë dhe paanshmërisë individuale dhe pavarësisë institucionale, shërbime të cilat janë të ndaluara shprehimisht nga ligjet në fuqi dhe me parimet e këtij Kodi.

Neni 8

Konflikti i interesit

Konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik.

1. Ka konflikt të interesi, kur interesi vetjak i një anëtari të universitetit, me përjashtim të studentit, bie në kundërshtim realisht apo potencialisht me interesin, jo vetëm ekonomik të universitetit por edhe me detyrën që duhet kryer.
2. Kur emëron përfaqësuesit e tij në organe, komisione apo përfaqësime të tjera, Universiteti merr përsipër të shmangë të gjitha konfliktet e mundshme dhe të veprojë para së gjithash në interes të universitetit.
3. Çdo anëtar i universitetit, që në një veprim apo rrethanë të caktuar ndeshet me konflikt të interesit duhet të njoftojë menjëherë organin ose personin përgjegjës apo eprorin e tij, si dhe duhet të kufizohet nga shqyrtimet apo vendimet të mundshme që kanë të bëjnë me të.
4. Autoritet drejtuese të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë kanë përgjegjësinë që të jenë të gatshëm për anëtarët e stafit, të cilët duan të raportojnë një çështje apo shqetësim në mënyrë konfidenciale dhe t'i trajtojnë me ndjeshmëri, paanshmëri, objektivitet dhe pa diskriminim në situata të tilla.



KREU II
INTEGRITETI AKADEMIK DHE SJELLA ETIKE NË MËSIMDHËNIE DHE KËRKIM SHKENCOR

Neni 9

Liria, autonomia dhe cilësia në mësimdhënie dhe kërkim

1. Universiteti njeh autonominë dhe lirinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor si vlera themelore për krijimin dhe transmetimin e dijes.
2. Universiteti promovon vlera dhe veprimtari cilësore me rëndësi për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në përputhje me standardet ndërkombëtare.
3. Personeli akademik, personeli menaxherial, hulumtuesit dhe të gjithë të tjerët të përfshirë në aktivitete mësimore dhe kërkimore, janë të obliguar të veprojnë në përputhje me standardet më të larta të ndershmërisë dhe integritetit. Aktivitete të tilla si plagjiaturë, keqpërdorim, mashtrim, keqpërfaqësim dhe falsifikim i të dhënave janë shprehimisht të ndaluara.

Neni 10

Veprimtaritë dhe përgjegjësitë gjatë procesit mësimor dhe marrëdhëniet me studentët

1. Personeli akademik qoftë i rregullt apo i angazhuar merr përsipër të kryejë veprimtaritë e tij mësimore në përputhje me organizimin dhe planifikimin e përgjithshëm të strukturave përkatëse të universitetit.
2. Personeli akademik nëpërmjet demonstrimit dhe nxitjes së përsosmërisë në kërkime, mësimdhënie, aktivitete profesionale dhe zhvillim të politikave në nivele të ndryshme.
3. Mësimdhënia është thelbësore për rolin e të gjithë personelit akademik. Mësimdhënësit janë të obliguar të kërkojnë përmirësim të vazhdueshëm të standardeve akademike.
4. Mësimdhënësit e kanë për obligim të kontribuojnë në zhvillimin e kurrikulave, hartimin e syllabusëve dhe në mënyrë krijuese të ofrojnë mësimdhënie cilësore në secilën disiplinë.
5. Personeli akademik duhet të jetë shembull i ndërtimit të marrëdhënieve korrekte me studentët dhe me personelin në përgjithësi në të gjitha nivelet. Personeli akademik është i obliguar që gjatë ndërtimit të marrëdhënieve me studentët dhe personelin në përgjithësi të kujdeset për rregullat e etikës.
6. Personeli akademik duhet të mos bëjë dhe të mos bëhet pre e provokimeve, ngacmimeve të të gjitha formave nga studentët apo personat e tjerë për shkak të punës, për qëllime që bien në kundërshtim me këtë Kod, aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
7. Personeli akademik duhet të përgatitë testet e provimeve, procesverbalet, njoftimet për web-faqe, dhe ta ruajë këtë dokumentacion në mënyrë konfidenciale duke i respektuar standardet ndërkombëtare për mbrojtje e privatësisë së individit.
8. Vlerësimi i studentëve bëhet sipas procedurave të miratuara sipas Rregullores së Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë për të cilat studentët njoftohen paraprakisht.
9. Personeli akademik i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë është i obliguar të përdorë gjuhën zyrtare dhe një fjalor të përshtatshëm, brenda normave të etikës së komunikimit dhe të sjelljes qytetare.
10. Personeli akademik i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë duhet të mos kërkojë dhe të mos pranojë në asnjë formë privilegje, përfitime, ndërhyrje, favorizime, pagesa apo dhurime nga studentë apo persona të tjerë, që kanë për qëllim marrjen e rezultateve të larta, apo favore e përfitime të tjera të cilat anëtar i personelit akademik mund t'i kryejë për shkak të detyrës. Identifikimi i rasteve të tilla ndëshkohet sipas procedurave disiplinore të parapara me



Rregullore për procedure disiplinore Nr.1443 /13 dhe iniciohen pranë Komisionit Disiplinor në nivel të Rektoratit

Neni 11

Shërbimet administrative, puna në komisione dhe mekanizmat e brendshëm

1. Për të përmbushur përgjegjësitë administrative, të vendimmarrjes, vlerësuese, këshillëdhënëse dhe të tjera, anëtarët e komisioneve/mekanismave përkatës duhet të jenë të pavarur dhe të garantojnë objektivitet.
2. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë garanton, siguron dhe mbron pavarësinë e këtyre komisioneve/mekanismave nëpërmjet infrastrukturës përkatëse ligjore.
3. Anëtarët e këtyre komisioneve-mekanismave të përberë nga personeli akademik duhet të zbatojnë me etikë, korrektësi dhe përpikmëri të gjitha përgjegjësitë që i janë përcaktuar me kontratë apo vendim të Dekanatit dhe Senatit.
4. Duhet të ruajnë konfidencialitetin e vendimeve të marra përpara miratimit dhe publikimit të tyre.
5. Personeli ndihmës-akademik (laborantët apo hulumtues brenda institutit) duhet të zbatojnë me etikë, korrektësi dhe përpikmëri të gjitha përgjegjësitë e që u janë caktuar me kontratë.
6. Ata janë përgjegjës për zbatimin e projekteve që u ngarkohen. Duhet të mbledhin dhe të ruajnë rezultatet e hulumtimit, e të njëjtat të mos i fshehin apo keqpërdorin për qëllime të tjera. Duhet t'i ruajnë me konfidencialitet të gjitha rezultatet dhe evidencat që rezultojnë nga puna kërkimore.
7. Drejtuesit e njësive akademike/Dekanët duhet të zbatojnë me etikë, korrektësi dhe përpikëri, paanshmëri të gjitha përgjegjësitë administrative dhe të auditimit që u janë përcaktuar.
8. Duhet të sigurojnë ruajtjen e normave etike institucionale, kolegjiale brenda njësisë që drejtojnë.
9. Duhet të mbikëqyrin punën dhe aktivitetin që zhvillon njësia që drejtojnë.
10. Duhet të jenë transparentë dhe të paanshëm në procesin e punësimit, drejtimit dhe auditimit për të siguruar cilësi, barazi dhe etikë në mjedisin e universitetit, duke përjashtuar interesat apo konfliktet vetjake.
11. Duhet të kultivojnë mjedis të shëndoshë akademik dhe të frenojnë veten nga veprimet që mund të rezultojnë në përçarje, presion, shantazh, nënçmim, dhe veprime arbitrare.

Neni 12

Veprimtaria kërkimore-shkencore

1. Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë siguron veprimtari kërkimore- shkencore për të gjithë komunitetin akademik dhe nga i njëjti kërkon që veprimtarinë e tyre kërkimore të ndërtojë mbi parimin e lirisë akademike, e cila garantohet nëpërmjet së drejtës për të zgjedhur fushën e kërkimit, për të grumbulluar të dhëna empirike dhe për t'i përdorur ato për qëllime kërkimore.
2. Mbështet kërkimet e pavarura dhe i mbron ato nga ndikimet negative qoftë brenda apo jashtë universitetit, si edhe nga ndikimet ideologjike, politike, ekonomike, fetare, teknologjike, etj.
3. Kërkon nga i gjithë komuniteti akademik dhe hulumtues që veprimtarinë e tyre kërkimore-shkencore të respektojë parimet themelore të integritetit akademik. Siç janë: a). garancia për cilësinë e kërkimit; b). ndershmëria në zhvillimin dhe në komunikimin e rezultateve me



- transparencë, drejtësi dhe paanshmëri; c). respekti për kolegët; d). kujdesi për trashëgiminë kulturore dhe mjedisin; e). përgjegjësia shoqërore për kërkimin.
4. I gjithë komuniteti akademik dhe ai hulumtues e kanë për detyrë të zbatojnë parimet, normat, standardet dhe kriteret e etikës së kërkimit gjatë punës së tyre kërkimore shkencore përkatëse, si dhe t'i minimizojnë rreziqet dhe shkeljet të integritetit.
 5. Ky Kod kërkon mbrojtjen e ndershmërisë intelektuale dhe përcakton përgjegjësitë personale të stafit akademik dhe hulumtues për veprimet e tyre për një varg praktikash që karakterizojnë sjelljen e përgjegjshme kërkimore duke përfshirë:
 - a. Ndershmëri në propozimin, kryerjen dhe raportimin e hulumtimit;
 - b. Transparencë në punën dhe publikimi i rezultateve;
 - c. Kolegialitet në ndërveprimet shkencore, komunikime të mira dhe ndarjen e buxhetit në mënyrë të barabartë;
 - d. Parandalim dhe trajtim të rasteve të cilën kanë të bëjnë me konflikt të interesit;
 - e. Mbrojtja e integritetit njerëzor gjatë kryerjes së hulumtimeve;
 - f. Kujdesi njerëzor ndaj kafshëve gjatë kryerjes së hulumtimeve;
 - g. Respektimi i përgjegjësive të ndërsjella të mentorëve dhe trajnuesve.
 - h. Fuqizon integritetin e kërkimit i cili nënkupton ekzaminimin e të dhënave me objektivitet dhe udhëheqjen e hulumtimit nga rezultatet, e kursesi nga konceptet e caktuara paraprakisht dhe të paverifikuara.
 6. Hulumtuesit dhe personeli vartës kërkimor sigurojnë që çdo kontratë a marrëveshje për publikimin ose përdorimin e rezultateve të kërkimit, të respektojë pronësinë intelektuale dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit.
 7. Anëtarët e komunitetit universitar duhet të respektojnë normat që kanë të bëjnë me pronën intelektuale dhe plagjiaturën.

Neni 13

Plagjiatura

1. Plagjiatura është përdorimi i ideve dhe punës së të tjerëve si të vetat, pa e cituar burimin origjinal, duke shkelur të drejtat e autorëve dhe krijimtarinë e tyre intelektuale. Plagjiatura mund të jetë e qëllimshme ose efekt i një qëndrimi jo të duhur.
2. Me plagjiaturë nënkuptojmë:
 - a. Të vjedhë dhe të përvetësojë (idetë ose fjalët e tjetrit) si të vetat;
 - b. Të përdorë (punën e një tjetri) pa cituar burimin;
 - c. Të kryejë vjedhje letrare;
 - d. Të paraqesë si të re dhe origjinale një ide apo produkt që rrjedh veçse nga një burim ekzistues.
3. Plagjiatura mund të jetë e dy llojeve:
 - a. Plagjiaturë e pakujdesshme ose plagjiaturë e paqëllimshme: Do të thotë që pafajësisht ose me pakujdesi prezantohet punimi i një personi tjetër pa e vërtetuar-cituar burimin.
 - b. Plagjiatura e vullnetshme ose e qëllimshme: Do të thotë prezantim me vetëdije dhe me qëllim punimin e personit tjetër si vepër e juaja pa e pranuar burimin.
 - c. Çdo tekst, disertacion, punim shkencor, raport, vepër artistike duhet t'i nënshtrohet softuerit të disponueshëm për të kontrolluar a përmban plagjiaturë. Çdo tekst që përmban tekst të huaj konsiderohet të jetë plagjiaturë.



- d. Përgjegjësia kryesore për plagjiaturë e mban individi si dhe njësia akademike apo instituti.
4. Studenti që paraqet një tezë, disertacion, dokumente teknike ose ndonjë dokument tjetër të tillë tek mbikëqyrësi/mentori detyrohet të nënshkruaj një marrëveshje dëshmie se dokumenti ka qenë i përgatitur prej tij ose asaj dhe që dokumenti është vepra e tij/saj origjinale dhe pa asnjë plagjiaturë.
5. Secili mbikëqyrës/ mentor duhet të pranoj një vërtetim të lëshuar nga personi përgjegjës i IT apo Menaxheri i kontratës, që dëshmon se puna e bërë nga studenti/-e nuk është plagjiaturë.

KREU III MOSDISKRIMINIMI DHE MUNDËSITË E BARABARTA

Neni 14 Ndalimi i diskriminimit

1. Të gjithë anëtarët e universitetit kanë të drejtën të trajtohen në mënyrë të barabartë, me mirëkuptim, respekt dhe nderim duke mos i'u nënshtruar në asnjë moment diskriminimit, direkt apo indirekt, për shkak të një apo më shumë faktorëve, duke përfshirë fenë, gjininë, orientimin seksual, ndërgjegjen dhe bindjet personale, aspektin fizik dhe ngjyrën, gjuhën, origjinën etnike apo shoqërore, nënshtetësinë, kushtet personale dhe të shëndetit, shtatëzaninë, zgjedhjet familjare, moshën etj.
2. Përbën diskriminim të drejtpërdrejtë kur, në bazë të cilitdo prej motiveve të përcaktuara dhe të sanksionuara në këtë Kod dhe në legjislacionin në fuqi, një individ trajtohet në mënyrë më pak të favorshme nga sa është trajtuar apo do trajtohej një tjetër në një situatë të ngjashme.
3. "Diskriminim i tërthortë" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do të vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në legjislacionin në fuqi, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.
4. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë kundërshton çdo formë të paragjyqimit të padrejtë shoqëror, çdo ngacmim apo shqetësim të ardhur për shkak të cilitdo prej motiveve të sanksionuara në këtë Kod dhe në legjislacionin në fuqi, çdo praktikë fyese apo poshtëruese, çdo ide të epërsisë morale të një grupi kundrejt një tjetri.
5. Është detyrë e universitetit dhe anëtarëve të tij të inkurajojë iniciativat e drejtuara në mbrojtjen dhe vlerësimin e kategorive të pafavorizuara, ndryshimin individual dhe kulturor.
6. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, duhet t'i japë mundësi të barabarta çdo personi gjatë procesit të rekrutimit, emërtimit, promovimit, pagesave, trajnimeve dhe praktikave të tjera të zbatuara në universitet pa dallim gjinie, race, origjine etnike, origjine kombëtare, ngjyre, besimi, feje, moshe, uniforme të shërbimit ose statusi që ai përfaqëson, me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike ose edhe bindjeve politike. I gjithë personeli akademik i universitetit duhet të respektojë standardet ndërkombëtare dhe normat Kushtetuese, ligjin kundër diskriminimit të cilët parandalojnë, respektojnë dhe ofrojnë mbrojtje ndajë sjelljeve diskriminuese.



Neni 15

Ngacmimet seksuale dhe gjuha dhe sjellja seksiste

1. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë ndalon sjelljet ngacmuese të natyrës seksuale, përdorimin e gjuhës seksiste, të kuptuara këto si sjellje diskriminuese që lëndojnë dinjitetin njerëzor dhe u siguron viktimave mbrojtjen e duhur, të lirë nga paragjykimi.
2. Ngacmimi seksual përkufizohet "çdo formë sjelljeje e padëshiruar verbale, jo-verbale apo fizike e një natyre seksuale, me qëllimin apo efektin e dhunimit të dinjitetit të një personi, në veçanti kur krijon një ambient kërcënues, armiqësor, degradues, poshtëruës ose fyes".
3. Ekzistenca e një pozicioni jo të barabartë ndërmjet atij që ngacmon dhe viktimës përbën element rëndues të keqpërdorimit apo ngacmimit seksual, për sa mund të verifikohet se:
 - a. Pranimi nga ana e viktimës është një kusht për regjistrimin, punësimin, emërimin në universitet, apo kalimin me suksese të vlerësimit apo provimit.
 - b. Pranimi ose refuzimi nga ana e viktimës përbëjnë elementë të vlerësimit që ka rëndësi për punësimin, emërimin, ngjitjen në karrierë, favore të ndryshme, apo të tjera vendime që kanë të bëjnë me viktimën;
4. Gjuha dhe sjellja seksiste, nënkupton komunikimet me përmbajtje të stereotipeve gjinore, sipas të cilave gratë duhet të shfaqin tipare të buta/ngrohtësi/jo shkathtësi/me pak inteligjencë dhe burrat duhet të shfaqin tipare të pakrahasueshme/superiore kompetencash ku si pasojë, përdoret gjuha që prodhon asimetri kolegjiale të statusit dhe fuqisë në favor të një gjinie.

Neni 16

Nepotizmi dhe favorizim

1. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë ndalon dhe dënon nepotizmin dhe favorizimin, të cilët bien në kundërshtim me dinjitetin njerëzor, me vlerësimin e meritave individuale, profesionalizmin dhe lirinë akademike, me ligjshmërinë, paanësinë dhe transparencën dhe i kërkon stafit akademik dhe çdo anëtar tjetër të universitetit të përmbahet nga të tilla praktika dhe t'i referojë Këshillit të Etikës rastet e sjelljeve të dyshimta.
2. Kemi të bëjmë me nepotizëm apo favorizëm, kur një pjesëtar i personelit akademik, ndihmës akademik apo administrativ, direkt ose indirekt, përdor autoritetin e tij apo aftësinë bindëse për të dhënë përfitime, për të favorizuar detyra apo emërimet, për të ndikuar mbi përfundimet e konkurseve apo në procedurat e përzgjedhjes që kanë të bëjnë, në veçanti, por jo ekskluzivisht, me fazën fillestare të formimit në karrierën universitare apo në dhënien përparësi të fëmijëve, familjarëve apo personave që bashkëjetojnë me ta.
3. Nepotizmi përfshin gjithashtu të gjitha format e favorizimeve ndaj studentëve dhe bashkëpunëtorëve në pozita vartëse, ku kjo kuptohet si sjellje e pajustificuar dhe arbitrare që bie në kundërshtim me rregullat e mosdiskriminimit dhe njohjes së meritës dhe mund të dëmtojë prestigjin e universitetit.

Neni 17

Dhuratat dhe favoret



1. Personeli akademik, menaxherial bashkëpunëtorët, të rregullt dhe të angazhuar e kanë të ndaluar të kërkojnë ose të pranojnë, dhurata, favore, pritje ose çfarëdo përfitimi tjetër, si dhe të ofrojnë premtime për punën e kryer, për veten, familjen, të afërmit, personat ose institucionet/organizatat me të cilat kanë marrëdhënie, që ndikojnë ose mund të ndikojnë në të ardhmen në paanësinë e kryerjes së detyrës, apo janë ose mund të jenë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.
2. Paragrafi 1 e këtij neni nuk zbatohet në rastin e ftesave zyrtare, të mikpritjes tradicionale, të dhuratave me vlerë simbolike ose tradicionale, të mirësjelljes, të cilat nuk krijojnë dyshime mbi paanshmërinë e punonjësit.
3. Në rast dyshimi mbi paanshmërinë e përfitimeve, është e nevojshme të këshillohet me Zyrën Qendrore administrative pranë Rektoratit.
4. Në qoftë se personelit akademik të lartcekur i ofrohet një avantazh i padrejtë, ai duhet:
 - a. ta refuzojë, pa pasur nevojë të pranojë atë për ta përdorur si provë;
 - b. të përpiqet që të identifikojë personin që i bën ofertën;
 - c. të raportojë përpjekjen, sa më shpejt që të jetë e mundur, tek eprori i tij.

KREU IV

PUBLIKIMI I TË DHËNAVE INSTITUCIONALE DHE PERSONALE

Neni 18

1. Duke e marrë parasysh nevojën për të avancuar me njohuritë dhe nevojën për të ndihmuar gjeneratat e ardhshme të mendimtarëve kritikë, Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë mbështet autonominë dhe lirinë e hulumtimit, si dhe lirinë për të komunikuar rezultatet e punës hulumtuese. Këto parime bazohen në një parim qendror - lirinë akademike - e cila duhet të zbatohet për tërë komunitetin e angazhuar në kërkime dhe mësimdhënie. Si bazament i kësaj është autonomia institucionale, e cila mbron arsimin e lartë dhe institucionet kërkimore nga ndërhyrjet politike dhe ekonomike dhe siguron vetëqeverisjen e komunitetit shkencor.

Neni 19

Publikimi i të dhënave të kërkimit shkencor

1. Të vetëdijshëm për rëndësinë dhe rolin që ka kërkimi në jetën akademike dhe shoqërore në përgjithësi, Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë mbështet dhe nxit të gjitha format e përhapjes së njohurive dhe rezultateve shkencore në mënyrë që të kontribuojë në zhvillimin dhe prosperitetin e shoqërisë.
2. Universiteti mbështet publikimin e të dhënave jo vetëm nëpërmjet komunikimit me shkrim dhe elektronik, por edhe nëpërmjet qasjes në arkivat institucionale për konsultim dhe ripërdorim të mundshëm të literaturës shkencore dhe rezultateve të kërkimit, brenda kufijve të ligjeve që mbrojnë pronësinë intelektuale, konfidencialitetin dhe ruajtjen e të dhënave personale.

Neni 20

Shprehja e lirë dhe mendimit kritik

1. Universiteti siguron dhe ofron mundësitë për debat dhe njeh lirinë e mendimit dhe shprehjes, madje edhe aty ku gjykimi është kritik, në mënyrë që të mbrojnë lirinë dhe autonominë akademike e cila mundëson përmbushjen e plotë akademike të një



- hulumtuesi/mësimdhënësi, gjithnjë duke respektuar standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut.
2. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë ndalon çdo veprim që ka të bëjë me shpifjen dhe fyerjen e kryer nga një individ kundër tjetrit apo të tjerëve, përfshi në disa rrethana një "subjekti juridik".
 - a. Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklaratë të pavërtetë të cilën publikuesi e di ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër.
 - b. Fyerja nënkupton deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese.
 3. Natyra e një veprimi të tillë keqberës është efekti negativ apo dëmi kundrejt emrit të mirë ose reputacionit të individit.
 4. Akti i fyerjes ka të bëjë me dhënien e deklaratave të rreme ose të pavërteta rreth një personi tjetër, që ka për qëllim të dëmtojë reputacionin e tij/saj në sytë e të tjerëve.
 5. Deklaratat e tilla mund të jenë a) një akuzë, b) një pohim, c) një sulm verbal ose formë tjetër fjalësh ose veprimi.

Neni 21

Format e komunikimit me shkrim

1. Komunikimi me shkrim është i domosdoshëm për të siguruar komunikim etik brenda institucionit dhe për të shmangur keqkuptimet që mund të lindin si pasojë e komunikimit verbal. Format e komunikimit me shkrim janë dy: shkresat zyrtare dhe komunikimet nëpërmjet postës elektronike.

Neni 22

Komunikimi elektronik

Të gjithë mesazhet e hartuara dhe/ose të dërguara nëpërmjet rrjetit të brendshëm të universitetit duhet të jenë në pajtim me Ligjin, Statutin, Rregulloret dhe Kodin e Etikës dhe të respektojnë rregullat e komunikimit zyrtar, ruajtjen e privatësisë dhe fshehtësisë së të dhënave siç kërkohet me ligj. Në veçanti komunikimi elektronik duhet të mbështetet në kritere si në vijim:

1. Adresa zyrtare e postës elektronike dhe mesazhet elektronike nuk janë pronë individuale e individëve.
2. Rrjeti elektronik i brendshëm është pronë e universitetit. Të gjitha informacionet që vendosen, hartohen, dërgohen dhe/ose merren në sistemin elektronik të institucionit, janë pronë e universitetit duke respektuar dispozitat e parashikuara në Ligjin për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të përafërta.
3. Çdo anëtar i të personelit akademik dhe menaxherial i caktohet një adresë poste elektronike me qëllim që të përdoret ekskluzivisht për nevoja të punës në lidhje me universitetin. Adresa është individuale dhe përdorimi i saj është i mbrojtur me fjalëkalim që zotërohet vetëm nga individi anëtar i personelit.
4. Me lënien e punës ose përfundimin e kontratës, universiteti i ndalon aksesin përdoruesit në sistemin e postës elektronike, përfshirë këtu të drejtën për të shkarkuar, dërguar, printuar ose rimarrë ndonjë mesazh të vendosur në sistem, pavarësisht nga dërguesi ose marrësi ose rëndësia e mesazhit përveç rasteve të parashikuara ndryshe.



5. Universiteti rezervon të drejtën që të ndryshojnë rrugën, destinacionin ose të pezullojë dërgimin e mesazheve në varësi të rrethanave duke njoftuar menjëherë dërguesin. Kjo përfshin, por nuk është e kufizuar me:
- Pengimin e dërgimit, alternimin, arkivimin ose fshirjen e dokumenteve të bashkëngjitur (attachment) ose kodit të mesazhit atëherë kur dyshohet se përbën rrezik për funksionimin e sistemit kompjuterik.
 - Eliminimin e përmbajtjeve shtesë në mesazhe (p.sh muzikë), që konsiderohen pa vlerë për universitetin dhe zënë vend në memorie.
 - Pengimin e dërgimit ose arkivimin e mesazheve me përmbajtje të dyshimtë
 - Mesazhe që përmbajnë dokumente të bashkëlidhura (attachment) me emra dhe prapashtesa të dyshimta.
 - Pengimin e dërgimit ose arkivimin e mesazheve të formuluar në gjuhë fyese.
 - Pengimin e dërgimit ose arkivimin e mesazheve që konsiderohen si jozyrtar ose reklama komerciale (spam).
 - Bashkëngjitjen e një deklarate në mesazhe të postës elektronike të institucionit.

Neni 23


Personeli menaxherial

- Ky Kod përcakton katër parime bazë të etikës që synojnë të udhëheqin vendimmarrjen etike dhe sjelljet e personelit menaxherial. Parimet e etikës që udhëheqin sjelljen menaxheriale janë:
 - integritet dhe paanshmëria
 - promovimi i të mirës publike
 - përkushtimi ndaj sistemit të qeverisjes
 - llogaridhënia dhe transparenca
- Personeli menaxherial i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë është i obliguar që gjatë kryerjes dhe marrjes së detyrave të aplikojë standardet më të larta etike, dhe nga ata pritet:
 - Të jenë të sinqertë, të paanshëm dhe të ndërgjegjshëm.
 - Të sigurojnë dhe respektojnë parimet themelore të drejtësisë dhe të etikës
 - Të raportojnë për keqbërjet, mashtrimet, sjelljet korruptive ose keqadministrimi të dyshuar tek organet kompetente universitare.

Neni 24

Përgjegjshmëria dhe integriteti

- Personeli menaxherial i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë duhet të reflektojë standard të lartë të integritetit personal e profesional gjatë veprimtarisë së punës, duke zbatuar normat ligjore përkatëse, për t'u siguruar që procesi i punës kryhet në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme.
- Me integritet nënkuptohet: të kenë ndershmëri, korrektësi, drejtësi e besnikëri ndaj institucionit, punës që kryejnë si dhe gjithë personelit të universitetit .
- Personeli menaxherial i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë duhet të përmbushë detyrat me kompetencë dhe paanshmëri, duke zbatuar standarde të larta profesionale në kryerjen e punës dhe duke mbajtur përgjegjësi për veprimet dhe vendimet e marra.
- Personeli menaxherial i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë gjatë veprimtarive të tij nuk duhet të dalë jashtë autoritetit që i jep funksioni.



5. Personeli menaxherial i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë obligohet që të sigurojë dhe respektojë privatësinë, të dhënat personale dhe konfidenciale gjatë ushtrimit të detyrës dhe të njëjtat t'i përdorë vetëm nëse i nevojiten për realizimin e detyrave funksionale.
6. Personeli menaxherial i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë duhet të garantojë mbrojtjen e informacionit që merr dhe të mos e bëjë atë publik pa autorizimin përkatës, përveç rasteve kur ka detyrim ligjor për ta bërë atë. Informacioni i mbledhur për shkak të detyrës funksionale apo detyrës së ngarkuar duhet të ruhet dhe nuk duhet të përdoret për përfitim personal, në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e etikës.

Neni 25

Paraqitja personale dhe respektimi i mjedisit të punës

Personeli menaxherial i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë duhet të ketë sjellje të mirë dhe të denjë në të gjitha rrethanat, me qëllim respektimin e normave të etikës dhe të ligjit gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Personeli menaxherial i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë duhet:

1. Të ruajë paraqitje serioze përpara studentëve dhe personave të tjerë gjatë orarit të punës, që përfshin veshje serioze e dinjitoze, përdorimin e një fjalori të zgjedhur dhe brenda normave të etikës e të sjelljes qytetare.
2. Të mos lejojë që marrëdhëniet personale të prekin ato profesionale, si dhe të mos krijojnë përshtypjen për një gjë të tillë.
3. Personeli menaxherial i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë duhet të mos kërkojë dhe të mos pranojë në asnjë formë privilegje, përfitime, ndërhyrje, favorizime, pagesa apo dhurime nga vartësit, personeli akademik, personeli administrativ, studentë apo persona të tjerë.
4. Të mos bëjë dallime ndër kolegë, vartës apo studentë për shkak të njohjeve apo preferencave personale.
5. Të mos bëjë dhe të mos bjerë pre e provokimeve, ngacmimeve të të gjitha formave nga vartësit, studentë, apo persona të tjerë për shkak të punës, për qëllime që bien në kundërshtim me këtë Kod, aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me normat morale.
6. Të trajtojë në mënyrë të barabartë vartësit, kolegët dhe studentët, duke shmangur cënime të dinjitetit, të personalitetit dhe të mendimeve të tyre profesionale, bindjeve politike dhe fetare.
7. Gjatë punës duhet që gjithnjë të shmangen edhe ato sjellje, që, megjithëse nuk arrijnë në nivelin ofendimeve, nënçmimit, e ngacmimit apo të abuzimit, mund të krijojnë një atmosferë jomiqësore apo frikë.
8. Të mos konsumojë pije alkoolike apo duhan në mjediset e institucionit.

Neni 26

Zbatimi i orarit të punës

Personeli menaxherial i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë duhet të respektojë dhe të zbatojë me efektivitet orarin e punës. Rastet e mosparaqitjes në detyrë duhet të shoqërohen me justifikim të arsyeshëm.

Neni 27

Studentët

Studentët kanë për detyrë të respektojnë dispozitat e këtij Kodi për aq kohë sa gëzojnë statusin e studentit. Studentët në hapësirën universitare, duhet:



1. Të zbatojnë orarin e mësimit dhe t'u përmbahen rregullave të sanksionuara në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë;
2. Të paraqiten në mënyrë serioze dhe dinjitoze në ambientet e institucionit, që nënkupton një veshje të përshtatshme, jo ekstravagante dhe duke mos ekspozuar trupin, universiteti nuk ndalon tatuazhet, pirsingun (shpimi), pikturimin me këna mirëpo universiteti nuk lejon veshjen e rrobave ose shfaqjen e tatuazheve, shenjave, simboleve, etj, të cilat tregojnë mesazhe të turpshme ose parulla sektare ose diskriminuese.
3. Të përdorin një fjalor të përshtatshëm, me intonacione të rregullta sipas normave të etikës, moralit dhe të mirësjelljes;
4. Të respektojnë personelin akademik dhe administrativ, shokët dhe rregullat e mësimit.
5. Të mos kryejnë veprime dhe gjeste provokuese ose ngacmuese ndaj personelit akademik, stafit administrativ ose studentëve të tjerë, në mjediset e institucionit;
6. Të mos ofrojnë në asnjë formë, privilegje, përfitime, ndërhyrje, favorizime, pagesa ose dhurime, vetë ose nëpërmjet personave të tjerë, me qëllim marrjen e rezultateve të larta, ose favorizime të tjera, të cilat stafi akademik ose anëtarë të tjerë të personelit të universitetit mund t'i kryejnë për shkak të detyrës;
7. Të mos kopjojnë, të mos mashtrojnë gjatë procesit mësimor, si dhe të mos shmangen nga shlyerja e detyrimeve mësimore;
8. Të mos konsumojnë pije alkoolike, substanca narkotike dhe duhan në ambientet e institucionit;
9. Të mos përdorin celular dhe ta mbajnë atë të fikur gjatë orarit të mësimit ose provimit në salla;
10. Të mbajnë me vete përgjatë procesit mësimor kartelën e studentit të dhënë nga Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë.
11. Kur merr pjesë në aktivitete studimore ose kërkimore, nuk duhet të përfshihet në plagjiaturë siç përcaktohet në Rregulloren e institucionit, të mos përmendë ose atribuojë punën e të tjerëve, të kalojë punën e të tjerëve si punën e tyre, ose të falsifikojë rezultatet, dhe duhet të respektojë parimet etike në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, dhe parimeve të tjera specifike në fushat e përcaktuara lëndore sipas rregullave të institucionit.
12. Ndërhyrje ose përçarje që pengon, dëmton misionin e universitetit, proceset ose funksionet që shkelin të drejtat e të tjerëve. Veprat penale përfshirë këtu janë: pushtimi i çfarëdo ndërtese të universitetit; ose pasurisë ose pjesë të tyre, pa autorizimin e universitetit, bllokimi i hyrjes ose daljes së ndonjë ndërtese të universitetit; vendosjen e zjarrit ose me ndonjë mjet tjetër, duke dëmtuar ndërtesë, pronën ose pasurinë universitare;
13. Nuk u lejohet zbatimi i programeve ose ndërmarrja e aktiviteteve/veprimeve që përbëjnë shkelje të së drejtës vendore ose shtetërore dhe politikave të universitetit. Studentët nuk ju lejohet të flasin në emër të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, me mediat.
14. Studentët nuk u lejohet të ftojnë në ambientet ose eventet e universitetit organizata të mediave, përjashtuar rastet kur merret leje me shkrim nga autoritetet drejtuese. Studentët si individë ose përfaqësues të organizatave studentore nuk u lejohet të hyjnë në marrëveshje verbale, ose me shkrim që kanë për qëllim të lidhin, detyrojnë, ose krijojnë ndonjë lloj përgjegjësie për Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë. Universiteti do t'i konsiderojë të gjithë këta studentë përgjegjës për pasojat financiare, juridike ose dëmet që mund të rezultojnë nga veprime të tilla të paautorizuara;



15. Të mos falsifikojë ose manipulojë shkresa dhe dokumente zyrtare të universitetit, të përdorin dokumentet dhe të dhënat zyrtare të universitetit për qëllime të tjera që mund të keqinterpretohen. Përdorimi i rrjetit elektronik të të dhënave ose ndonjë pajisje elektronike në pronësi dhe administrim të universitetit për qëllime të paligjshme/të pahijshme, në shkelje të rregullores, politikave të universitetit ose ligjeve është e ndaluar;
16. Të mos bëjë përvetësime të paautorizuara të aseteve ose shërbimeve brenda universitetit.
17. Mbajtja pa leje e armëve vdekjeprurëse (armë zjarri, lëndë shpërthyes, thika, etj.) ose që përbëjnë rrezik për mirëqenien e anëtarëve të komunitetit universitar janë të ndaluara. Nuk lejohet zotërimi, përdorimi, ruajtja, ose transportimi i armëve të zjarrit, eksplozivit fishekzjarrës, ose kimikateve të rrezikshme, përjashtuar mjetet/lëndët për të cilat ekziston autorizimi për përdorim në klasë.
18. Të mos bëjë dëshmi të rrejshme ose fshehje të evidencave përballë Organeve Kolegjiale ose anëtarëve të personelit të universitetit.

KREU V MASAT DISIPLINORE

Neni 28

Sqarime dhe raportimet e shkeljeve

1. Personeli akademik, menaxherial, ndihmës-akademik, hulumtuesit, bashkëpunëtorë dhe studente tjerë të universitetit apo palë me interes mund të paraqesin rastet e shkeljes/eve të pretenduara të integritetit dhe etikës në mësimdhënie dhe në hulumtime shkencore pranë Këshillit të Etikës.
2. Personeli akademik, menaxherial, ndihmës-akademik, hulumtuesit bashkëpunëtorë dhe studente të tjerë të universitetit pritet të raportojnë për sjelljet jo-akademike dhe/ose shkeljen e integritetit dhe etikës akademike, hulumtuese, shkencore të këtij Kodi pranë Zyrës së Protokollit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, drejtuar Këshillit të Etikës.
3. Janë të detyruar të gjithë drejtuesit e universitetit, fakulteteve, departamenteve dhe kryetarët e degëve të ndryshme të identifikojnë raste të shkeljes së Kodit të Etikës së universitetit dhe t'i raportojnë ato pranë Këshillit të Etikës. Secili person që është subjekt i zbatimit të dispozitave të këtij Kodi ka të drejtë të denoncojë ose të raportojë vetë, nëpërmjet raportit ose organeve përfaqësuese të studentëve, shkeljet e dispozitave të këtij Kodi, përpara anëtarëve të Këshillit të Etikës ose Rektorit, i cili këshillohet edhe me Këshillin e Etikës.

Neni 29

Llojet e masave disiplinore

1. Përveç shkeljeve që ndëshkohen nga dispozitat e Statutit dhe të Rregullores së Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, si dhe të atyre që përbëjnë figurë veprash penale që trajtohen me dispozitat e Kodit Penal, shkelja e dispozitave të parashikuara në këtë Kod përbën shkelje disiplinore me të cilin parashikohen:
 - a. Masat disiplinore me "Vërejtje me shkrim", "Vërejtje me paralajmërim për përjashtim" nga universiteti". Në rast se këto shkelje paraqesin raste që përbëjnë veprë penale ose veprime që rezultojnë plagjiaturë, Këshilli i Etikës i propozon autoritetit drejtues, ndëshkime të tjera më të rënda siç janë Largim nga universiteti dhe marrjen e titullit shkencor.



- b. Për shkeljen e pikave të nenit 3 dhe të nenit 7 sipas rastit, parashikohet ndjekje penale, dhe/ose procedim disiplinor deri në largim nga puna. Në rast se anëtari i personelit akademik dhe menaxherial dyshohet apo ka pasur tentative për shkelje të ndonjëres prej pikave të nenit 3, atij i hiqet e drejta të kandidojë ose të rikandidojë në një pozicion të lartë administrativ. Në rast se ka pasur tentative të shkeljes së nenit 7, anëtari i personelit akademik dhe menaxherial nuk gëzon të drejtën të kandidojë ose rikandidojë në pozicione drejtuese ose përfaqësuese.
- c. Për shkeljen e pikës 2. të nenit 12 sipas rastit, parashikohet formimi i komisionit për verifikimin e dyshimeve i cili obligohet të punojë ngushtë me Këshillin e Etikës. Në rast se vërtetohet shkelja e pikës 2. të nenit 12, atij i hiqet grada ose titulli shkencor i dhënë nga universiteti dhe i njëjti largohet nga universiteti.
- d. Për shkeljen e pikës 1. të nenit 15 si dhe pikave 1 dhe 3 të nenit 16, parashikohet masa me "Vërejtje me paralajmërim për përjashtim" nga universiteti" e cila i bashkohet dosjes së tij/saj.
- e. Për shkeljen e pikës 1 dhe 4 të nenit 14, shqiptohet masa Largim nga universiteti. Ndërsa për shkeljen e pikës 1 (përdorim i gjuhës seksiste) shqiptohet masa "Vërejtje me shkrim". Në rast se shkelja përsëritet, edhe pas tërheqjes së Vërejtjes me shkrim, atëherë shqiptohet masa "Vërejtje me paralajmërim për përjashtim" nga universiteti"
- f. Për shkeljen e të gjitha pikave të nenit 9 si dhe të pikës 1 së nenit 23, parashikohet masa Vërejtje me Shkrim.
- g. Në rast se shkelja përsëritet, edhe pas tërheqjes së Vërejtjes me shkrim, atëherë shqiptohet masa "Vërejtje me paralajmërim për përjashtim" nga universiteti"
- h. Për shkeljen e pikave të neneve 17 dhe 18, të cilat nuk përbëjnë vepër penale, ndaj personelit akademik, menaxherial, ndihmës akademik, hulumtuesit, student dhe të tjerët që kanë lidhje direkte me universitet mund të shqiptohet masa disiplinore " Vërejtje me shkrim". Në rast se shkelja përsëritet, edhe pas tërheqjes së Vërejtjes me shkrim, atëherë shqiptohet masa "Vërejtje me paralajmërim për përjashtim" nga universiteti. Njëkohësisht, atij/asaj i hiqet e drejta të kandidojë apo të rikandidojë në pozicione drejtuese ose përfaqësuese.
- i. Për shkeljen e pikave prej 3 deri 6 të nenit 11, parashikohet ndëshkim me "Vërejtje me shkrim", i cili i bashkohet dosjes se tij/saj.
- j. Për shkeljen e neneve 4 dhe 5, shqiptohet masa Vërejtje me shkrim. Në rast se shkelja përsëritet atëherë shqiptohet masa "Vërejtje me paralajmërim për përjashtim" nga universiteti"
- k. Marrja e vendimit duhet të bëhet brenda 30 por jo më larg se 60 ditë pune pas dorëzimit të ankesës për shqyrtim në Këshill të Etikës.

Neni 30

Organi disiplinor

1. Këshilli i Etikës është organi që krijohet dhe funksionon në përputhje me Statutin, Rregulloret e universitetit dhe Kodin e Etikës.
2. Në zbatim të këtij Kodi, kompetencat e Këshillit të Etikës janë të rregulluara me Rregulloren e Punës për Këshillin e Etikës, neni 3.

3. Veprimtaria dhe procedurat e shqyrtimit të rasteve nga ana e Këshillit të Etikës përcaktohen nga Rregullorja e Punës për Këshillin e Etikës.
4. Komisioni për Ankesa në nivel të Rektoratit është i vetmi mekanizëm i cili ka kompetenca të shqyrtojë ankesat lidhur me vendimet e Këshillit të Etikës.

Neni 31

Dispozita përfundimtare Shpërndarja dhe zbatimi i Kodit të Etikës

1. Është detyrë e universitetit të përkrahë shpërndarjen sa më të gjerë të Kodit të Etikës nëpërmjet njoftimeve, takimeve, veprimtarive didaktike dhe çdo mënyre tjetër që konsiderohet e duhur për këtë qëllim.
2. Universiteti ndërhyr menjëherë, me çdo mjet për zbatimin e këtij kodi, në rastet kur kjo gjë bëhet e nevojshme.
3. Ky kod shfuqizon kodin e mëparshëm dhe hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.
4. Të gjitha rregulloret duhet të harmonizohen me dispozitat e këtij Kodi, brenda tre (3) muajve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij Kodi.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues të UHZ-së

Dr.Sc. Ardian Berisha

